

Njoftimi i Përqendrimit me të cilin Alvin AG, Zvicër do të fitojë kontroll të pavarur mbi Instant Vin Gejming Limited, Mbretëria e Bashkuar

(lënda nr. 08-55 /2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 01.03.2024, te Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin Alvin AG me seli të regjistruar në Veinmarkt 9, 6004 Lucern, Zvicër do të fitojë kontroll të pavarur mbi Instant Vin Gejming Limited me seli të regjistruar në Katin e 1-rë , Old Strit Jard 2, Londër, EC1Y 8AF, Mbretëria e Bashkuar, përmes blerjes së pjesëve.

- **Alvin AG** është një shoqëri holding e themeluar në Zvicër që blen dhe menaxhon pjesët në kompanitë e industrisë së lojërave dhe është kompania mëmë e Grupit Alvin. Grupi Alvin është një operator lotarie shumëkombëshe me një prani të konsiderueshme në Austri, Republikën Çeke, Greqi, Qipro, Itali, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Illinois) dhe përfundimisht është në pronësi të Grupit KCCG.

Grupi KCCG është një grup privat investimesh me më shumë se 6,000 punonjës që është i pranishëm në 18 vende. Ai është kryesisht aktiv në fushat e naftës dhe gazit, inxhinierisë, lojërave dhe argëtimit, teknologjisë, teknologjisë së informacionit dhe pasurive të paluajtshme.

Grupi KCCG është i pranishëm në tregun e Maqedonisë së Veriut kryesisht në fushën e punës me терминалет e video lotarisë, përmes shoqërive të mëposhtme:

- KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIJA SHPK Shkup, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup - Gazi Babë, me seli në Bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup-Gazi Babë, me aktivitet prioritar Lojëra e fatit dhe basteve;
- Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup - Gazi Babë, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup-Gazi Babë, me aktivitet prioritar Lojëra e fatit dhe basteve.

Përveç kësaj, Grupi KCCG ka aktivitete të caktuara në Maqedoninë e Veriut përmes kontrollit të tij mbi Grupin Kinshift (më parë:Grupi Seavus) dhe Grupin Musala. Në Maqedoninë e Veriut, Grupi Kinshift (më parë:Grupi Seavus) ka shoqëritë e mëposhtme të varura:

- KINSHIFT SHPKNJP Shkup (me emrin e mëparshëm SEAVUS SHPKNJP Shkup), me seli të regjistruar në adresën rr. 11 tetori nr. 33A/Qendra 1, Shkup-Qendra, me aktivitet prioritar Programim kompjuterik;
- KINSHIFT AKADEMI SHPKNJP Shkup (me emrin e mëparshëm SEAVUS QENDRA EDUKATIVE DHE ZHVILLIMORE SHPKNJP Shkup), me seli të regjistruar në adresën rr. 11 tetor nr. 33A/Qendra 1, Shkup-Qendra, me aktivitet prioritar: arsim tjetër, që nuk përmendet diku tjetër.

Shoqëria e varur e Grupit Musala në Maqedoninë e Veriut është Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime MUSALA SOFT SHPKNJP Skopje, me seli të regjistruar në rr. Filipi II i Maqedonisë nr. 3-kati 4, zyra 4003, Shkup, me aktivitet prioritar: programim kompjuterik.

- **Instant Vin Gejming Limited** (Instant Win Gaming Limited), me seli të regjistruar në Katin e 1-rë, Old Strit Yard 2, Londër, EC1Y 8AF, Mbretëria e Bashkuar. Shoqëria e synuar u themelua në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Vellsit dhe është një ofruer i lojërave online, të çastit në internet për lotaritë. Shoqëria e synuar ofron shërbim të plotë për lotaritë, nga strategjitë dhe konsultimi deri te dizajni dhe

zhvillimi. Ajo ka më shumë se dhjetë vjet përvojë në krijimin e lojërave të çastit me cilësi të lartë që kanë shitje të larta dhe njohuri strategjike për t'i bërë ato të funksionojnë.

Instant Vin Gejming Limited nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut në vitin e kaluar.

Përqendrimi i planifikuar bëhet në atë mënyrë që Alvin AG, nëpërmjet shoqërisë së varur të saj të kontrolluar në mënyrë të pavarur, të themeluar në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit, do të blejë pjesë në shoqërinë e synuar dhe do të marrë kontroll të pavarur mbi të njëjtën.

Tregu relevant për përqendrim është tregu i dizajnit dhe prodhimit në lojërat e fatit të çastit në internet në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

04.03.2024

Shkup